

**mr. Rejhan Neziri**

**GJENDJA EKONOMIKE  
E BOTËS ISLAME SOT  
DHE SFIDAT PËRPARA SAJ**

**Temë tribune e mbajtur në Xhaminë e Baselit  
në Zvicër më 23 tetor 2005**

**Kreuzlingen, 2005**

## A) GJENDJA AKTUALE EKONOMIKE E BOTËS ISLAME

Bota, marrë në përgjithësi, është e ndarë në njësi, të cilat i bashkojnë faktorë të përbashkët. Edhe Bota Islame konsiderohet një ndarje e rëndësishme botërore, këtë e bashkojnë qytetërimi, historia, gjeografia, interesat politike e ekonomike.

Sot, në botë numri i muslimanëve është përafërsisht një miliardë e gjysmë. Mbi dy të tretat e tyre janë banorë të shteteve islame, ndërkaq një e treta janë pakica, jetojnë në shtete joislame, ose në shtete që mund të konsiderohen islame, por që akoma nuk i janë bashkuar Organizatës së Konferencës Islamike, si B e H etj.

**Sipërfaqja** e Botës Islame përfshin përafërsisht 32 milionë km<sup>2</sup> ose përafërsisht ¼ e sipërfaqes së thatë të botës, e cila ka afërsisht 149 milionë km<sup>2</sup>, kurse gjatësia e kufirit tokësor përafërsisht është 168.760 km.

Shteti me sipërfaqe më të madhe i Botës Islame është Kazakistani (2.717.300 km<sup>2</sup>), që është i 11-ti në botë për nga sipërfaqja; pasojnë: Sudani (2.505.810 km<sup>2</sup>), dhe Algjeria (2.381.740 km<sup>2</sup>). Ndërkaq, shtetet me sipërfaqe më të vogël janë Maldivi (300 km<sup>2</sup>), Bahrejni (620 km<sup>2</sup>), Ishujt e Bregut të Fildishtë (2.170 km<sup>2</sup>).

Nga e tërë sipërfaqja e Botës Islame, vetëm 11.3% është sipërfaqe bujqësore, nga e cila 658.000 km<sup>2</sup> ose 18% madje edhe ujiten.

**Numri i banorëve** të Botës Islame arrin në 1.361.441.883, që përbën 22.7% të numrit të përgjithshëm të botës (përafërsisht 6 miliardë banorë).

Indonezia është shteti islam që ka më së shumti banorë (afro 225 milionë banorë), pason Pakistani (afro 142 milionë) dhe Bangladeshi (129 milionë). Vetëm këto tri shtete përbëjnë 36% të numrit të gjithmbarshëm të banorëve të Botës Islame. Në anën tjetër Maldivi është shteti me numër më të vogël të banorëve (afro 301.000 banorë) dhe Brunei (336.000).

Në mesin e 40 shteteve të botës me më shumë banorë, dhjetë janë islame:

- Indonezia – në vendin e katërt
- Pakistani – në vendin e shtatë
- Nigeria – në vendin e dhjetë.

Shkalla e **arsimimit** në Botën Islame arrin 63.2% në kohën kur mesatarja e investimeve për të nuk tejkalon 4% nga të hyrat kombëtare; kjo në vendet e zhvilluara arrin 5,18%.

Mesatarja e investimit ditor **në shëndetësi** për kokë banori arrin në 123\$. Këto investime reflektojnë nivelin e zhvillimit të shtetit përkatës. Katari më së paku investon në shëndetësi, (vetëm 27\$), pason Brunei me 32\$, pastaj Emiratet e Bashkuara Arabe me 35\$. Shtetet që investojnë më së shumti në shëndetësi janë Somalia – 191\$, Najgeri – 185\$, Afganistani – 184\$.

Bota Islame ka investuar në **rrafshin ushtarak** më 1997 më shumë se 72 miliardë \$, Saudia prin në vendin e parë me investimet në ushtri gjatë vitit 1997 afro 18 miliardë \$, pason Turqia me 8 miliardë \$, pastaj Indonezia me 5 miliardë \$. Në anën tjetër, shtetet që më së paku investojnë në përgatitje ushtarake janë: Guajana dhe Guineja Bisao (nga 7 milionë \$ secila prej tyre), pason Gambia (me 15 milionë \$), dhe Surinami (17 milionë \$).

Në Botën Islame **prodhimi i përgjithshëm vendor** (përfshin prodhimet ekonomike, përpunimin e lëndës së parë dhe të gjitha shërbimet e tjera deri në pëdorimin final) arrin në 3.483 miliardë \$ për vitin 1999. Në kuadër të Botës Islame me prodhimin më lartë vendor është Indonezia (602 miliardë \$), pason Turqia me 425 miliardë, dhe pastaj vjen Irani me 340 miliardë \$. Ndërkaq, prodhimin më të vogël e kanë: Bregu i Fildishitë (410 milionë \$), dhe Maldivi me 540 milionë \$.

Pjesëmarrja e individit në prodhimin e gjithmbarshëm kombëtar është 3.934 \$, më e larta është në Kuvajt (22,700 \$), pasojnë Emiratet e Bashkuara Arabe (17,400 \$) pastaj Katari (17,100 \$); ndërkaq më e ulëta është në Siera-Leone (530 \$), pasojnë Somalia (600 \$) dhe Bregu i Fildishtë (700 \$).

Nga të hyrat vendore të përgjithshme në bujqësi, industri dhe shërbime publike investohen: 24% në bujqësi, 30% në industri dhe 46% në shërbimet publike.

Mesatarja e banorëve të Botës Islame që janë **nën nivelin e varfërisë** arrin në 37%, më e larta është në Siera-Leone (68%), në Gambi (64%) dhe në Ugandë (55%).

Mesatarja e **devalvimit të valutës** për vitin 2000 ka qenë 14%. Përqindja më e lartë për të njëjtin vit në Surinam ka qenë 170%, pastaj në Irak 135% dhe në Turqi 65%. Përqindja më e ulët e devalvimit ka qenë në Azerbajxhan 6,8%, pastaj në Saudi 1,2,% dhe në Oman 0,07%.

**Fuqia punëtore** në Botën Islame llogaritet 395 milionë ose 29% nga numri i përgjithshëm i banorëve. Nga informatat që posedojmë, vërehet se në 35

shtete të Botës Islame niveli i papunësisë arrin në 19,2%. Gjatë vitit 1999 sasia e importit ka arritur 431 miliardë \$, kurse eksporti 358 miliardë \$.

**Lëndët natyrore** që gjenden me shumicë në Botën Islame, janë *nafta* dhe gazi *natyror*. Naftë kanë 35 shtete islame dhe prodhimi i saj është 43% e prodhimit botëror. Ndërkaq, gazi natyror gjendet në 25 shtete islame dhe paraqet 8% nga prodhimi botëror. Bota Islame është mjaft e pasur me lëndë të tjera, si xehe, ujëra dhe tokë pjellore; këto shtete prodhojnë 47% të aluminit nga i tërë prodhimi botëror.

Siç shihet, **varfëria** – paraqet sfidën më të rëndësishme të shoqërisë islame. Ç’është e drejta, sot në botë jetojnë afër 1,3 miliardë njerëz nën kufirin e varfërisë.

Në Botën Islame 37% të banorëve ose 504 milionë njerëz jetojnë nën nivelin e varfërisë, me se në shkallë botërore marrin pjesë me 39%, që do të thotë se më shumë se 1/3 e banorëve të botës, të cilët jetojnë nën nivelin e varfërisë, janë banorë të shteteve të Botës Islame.<sup>1</sup>

Një indikator tjetër që flet për këtë gjendje të mjeruar të botës islame janë edhe të ardhurat kombëtare për kokë banori, përderisa këto të ardhura në vendet e zhvilluara nuk bie nën 10 mijë \$ për vit (p.sh. në Zvicër këto /Gross National Income-GNI/ janë 36 987 \$ per person, në vend të parë është Luxemburgu me 37 499 \$ per person; [www.natiomaster.com](http://www.natiomaster.com)), në shumë vende islame, e sidomos në ato të Afrikës, lëviz ndërmjet 300-600 \$, kurse në ato shtete islame me zhvillim të mesëm të Azisë qendrore kjo shifër mezi e arrinë shumë prej 2000 \$.

## **B) CILAT JANË SHKAQET E NJË NGECJEJE TË KËTILLË**

Kur e shikojmë këtë gjendje të mjerueshme të botës islame, doemos pyetemi a thua pse kjo ndodh kështu. Krejt në fillim duhet të bëjmë dallimin midis varfërisë si pasojë e asaj që ka dashtur Zoti e shprehur përmes fatkeqësive natyrore apo mungesës së resurseve natyrore dhe varfërisë së paraqitur si pasojë e dorës së njeriut. Për kategorinë e parë s’kemi çfarë të flasim, sepse ajo vjen jashta vullnetit tonë dhe nuk varet prej nesh. Ndaj kësaj duhet bërë durim dhe duhen marrë masat për zbutjen e saj, sepse kjo e godet si shtetin islam ashtu edhe atë joislam. Edhe pse, edhe në procesin e tejkalimit të

---

<sup>1</sup> Esmae Melkavi, „Pasqyrë e shkurtër për botën islame“, përktheu: R. Rexhepi; Takvim i Bashkësisë Islame të Kosovës, 1422-23/2002, fq. 227-235.

situatave të rënda natyrore, shtetet e pasura dallojnë shumë prej atyre të varfërave.

Ne do të merremi me shkaqet e varfërisë që vijnë si pasojë e dorës njerëzore.

**1. Përtacia e muslimanëve.** Para se të fajësojmë dikënd tjetër për dobësinë tonë është mirë të fillojmë me vetveten. Përtacia (dembellëku) e muslimanëve, pa kurrfarë dyshimi, është shkaku kryesor për ngecjen e muslimanëve. Për këtë, më tepër ju preferoj të lexoni librin *Pse muslimanët janë të prapambetur, ndërsa të tjerët të përparuar* të autorit Emir Shekib Arslan, pa mos u futur shumë në këtë drejtim...

**2. Moskuptimi i drejtë i disa parimeve islame ose shtrembërimi i tyre gjatë historisë.** Këtu para së gjithash duhet të theksojmë kuptimin e gabueshëm të disa ajeteve dhe haditheve që flasin për zhvillimin e jetës ekonomike, si identifikimi marramendës e tronditës që i bëhet varfërisë në disfavor të zenginllëkut, pra nga qarqe të caktuara më shumë preferohet varfëria dhe quhet vlerë, sesa të qenët i pasur. Edhe pse nuk mund të hasësh asnjë ajet apo hadith të Pejgamberit a. s. ku lavdërohet varfëria - mos e ngatërro me vlerën e të varfërit musliman të durueshëm dhe me lavdërimin e maturisë që duhet ta kultivojë njeriu besimtar - sërish gjatë gjithë historisë po edhe sot në disa vise mund të hasen njerëz dhe qarqe që më tepër e çmojnë varfërinë sesa të qenët i pasur. Këtë ata e mbështesin në disa hadithe ku Pejgamberi a. s. i lavdëron disa muslimanë fukarenjë të cilët ka dashur të mbjellë ndjenjën e superioritetit e të mirësisë së tyre edhe pse janë të varfër e kurrësesi të mos kaplohen nga ndjenja e inferioritetit e të mendojnë se vetem muslimanët e pasur janë të mirë e mund të hyjnë në Xhennet. Ndërkaq mirëfilli dihen mjaft hadithe të Muhammedit a. s. ku lavdërohet “dora që jep” dhe ku vetë ai Pejgamber “kërkon strehim te Zoti prej mosbesimit, vështirësive të jetës e prej varfërisë”. Akoma më e njohur është thënia e tij, se: “Varfëria gati sa nuk të çon në kufër (mosbesim)”...

Një keqinterpretim tjetër është edhe porosia e Pejgamberit a. s. për t’u shtuar sa më shumë, me çka ai do të mburret nesër në Ahiret ndaj ummeteve të tjera me numrin e madh të ndjekësve të tij. Kjo ka të bëjë me ‘planifikimin familjar’ dhe si e këtillë shpesh është keqkuptuar e keqinterpretuar, kinse muslimani nuk e ka të lejuar të kujdeset për planifikimin e familjes dhe sado fëmijë që të bëjë këtë ia mvesh dëshirës së Zotit dhe kërkesës së Muhammedit a.s., e duke i anashkaluar shumë të vërteta të tjera kur’anore dhe peygamberike, prej të cilave më e qartë është sërish thënia e Muhammedit a. s. kur thotë: “Do të vijë koha kur popujt tjerë do t’u vërsulen muslimanëve, sikurse të uriturit që u vërsulen enëve të ushqimit” E pyesin: “Pse do të ndodhë kështu, a mos do të jetë i paktë numri i muslimanëve, ja Resulallah?” Ai përgjigjet: “Jo, për nga numri ata

do të jenë të shumtë, mirëpo do të jenë të pavlefshëm sikurse mbeturinat që mbeten mbi sipërfaqen e ujit që sjell vërshima. All-llahu atë kohë do ta shkulë prej zemrave të armiqve tuaj frikën që ata e ndjejnë ndaj jush, kurse në zemrat tuaja do të mbjellë ‘vehnin’”. Dikush e pyeti: “Po ç’është ‘vehni’, ja Resulallah?” Tha: “Dashuria ndaj kësaj bote dhe mungesa e dëshirës për të vdekur”<sup>2</sup> A thua nuk ka mundësi që muslimani të kujdeset pak më shumë që secilit fëmijë që do të lindë t’ia ofrojë të gjitha mundësitë për shkollim, arsimim, edukim, punësim etj. duke i çuar në vend të gjitha obligimet që prindi i ka ndaj fëmijës së tij, sesa të kujdeset thjesht vetëm për numrin e fëmijëve?!

**3. Vjedhja dhe plaçkitja e pasurive natyrore të botës islame nga ana e kolonizatorëve.** Ata këtë e kanë bërë në shekullin XVIII-XIX, duke i bartur pasuritë më të çmueshme natyrore të atyre viseve në vendet e tyre me çka ka marrë një hov të dukshëm zhvillimi ekonomik i të njëjtave. Edhe pas periudhës së kolonizimit të drejtpërdrejtë, kur tanimë udhëheqësia e shteteve muslimane u la në duart e muslimanëve të dëgjueshëm ndaj ish kolonizatorëve të tyre, të njëjtat resurse vazhdojnë të eksploatohen në dy forma të ndryshme më kryesore, a) Përmes shfrytëzimit të lirë të punës së krahut në vendet muslimane dhe b) shitjes së prodhimeve vendore në tregjet e ish kolonizatorëve me çmime tejet minimale madje edhe simbolike. Kështu ndodh me naftën, me gazin natyror, me xehet, me prodhimet bujqësore, pyjore etj. Me këtë, qeveritë kukulla të këtyre vendeve shërbejnë vetëm për transportimin e këtyre të mirave të këto shtete, punë që në kohën e kolonizimit të drejtpërdrejtë këtë e bënin vetë perëndimorët. Ky lloj eksploatimi i resurseve të muslimanëve nga perëndimorët sot mbështetet edhe nga ajo që sot mund ta quajmë me termin “politikë varfëruese”, sidomos përmes krijimit të varshmërisë ekonomike ndaj shteteve të fuqishme, ku rol kryesor luajnë borxhet e jashtme të shteteve muslimane. Megjithëse këto borxhe, njihen me emrin kredi, ato nuk jepen edhe aq lehtë. Po edhe kur të jepen, kthimi i tyre kërkohet të bëhet me kamatë të pavolitshme. Meqë këto shtete thuhet asnjëherë nuk do të mund të ngrejë kokën nga këto borxhe, sa herë kur do të përpiqen të jenë të padëgjueshme ndaj patronëve të tyre, u kërkohet kthimi i borxhit, çka drejtpërdrejtë nënkupton një formë të re kolonializimi, robërimi e eksploatimi. Madje në të shumtën e rasteve ndodh që, një shtet të marrë kredi për të paguar shumën e kamatës që duhet ta dorëzojë në afatin e caktuar, kredi mbi kredi...Institucionet bazë të

---

<sup>2</sup> Ebu Davudi „Melahim“, 4/165, hadithi nr. 4129, Mundhiriu, Muhtasari i Ebu Davudit; Ahmed b. Hanbel, 5/278; el-Albani, *Silsiletu ’l-ehadithis-sahihah*, 958.

cilat këto forca i kanë krijuar për këtë qëllim janë FMN-ja (Fondi Monetar Ndërkombëtar\*) dhe Banka Botërore.<sup>3</sup>

- 4. Zbatimi i politikave të gabuara ekonomike dhe menaxhuese nga vendorët.** Kjo është vazhdimësi e asaj që thamë më lart, se shumica e pushtetmbajtësve muslimanë janë njerëzit më të dëgjueshëm ndaj neokolonizatorëve, andaj ata për ta ruajtur pushtetin e tyre thuajse gjithherë i zbatojnë politikat ekonomike të papërshtatshme për vendet e tyre, ngase këta janë njerëz të shkëputur nga populli i vet, si nga aspekti ekonomik ashtu edhe nga ai fetar e kulturor. Në fakt ky është rezultat i zbatimit të asaj politike që theksohet në protokolet e të urtëve sionistë: “Nevoja për bukë të përditshme do t’i hedhë gojimët (johebrenjtë) në vështirësi dhe do t’i bëjë skllëvër të përlurur”.<sup>4</sup>

## **C) SFIDAT MË TË MËDHA QË QËNDROJNË PËRPARA BOTËS ISLAME**

Krahas krejt kësaj që thamë, sikur të mos mjaftonte me kaq, bota islame vazhdon të lëngojë e të ndeshet me sfida të ndryshme dhe vështirë të kapërcyeshme. Disa prej këtyre problemeve serioze shkaktohen nga vetë mesi i muslimanëve, kurse disa të tjera nga të tjerët. Ndër sfidat më të mëdha të këtyre dy llojeve dëshiroj të veçoj me sa vijon më poshtë, duke mos i shpërfillur edhe të tjerat që mund të jenë të efektshme në këtë drejtim.

- 1. Korrupcioni.** S’ka dyshim se mitoja (ryshfeti) dhe korrupcioni janë pjesë përbërëse e shoqërive të varfëra dhe veçori e dalluar e tyre, andaj edhe bota islame, edhe pse me pasuri natyrore të bollshme, por përsëri e varfër, nuk ka mund të zhvishet e të distancohet nga ky tipar i shëmtuar. Korrupcioni në fakt është shtytje e dikujt me anë ryshfeteshtj. të shkelë ligjet ose të veprojë në kundërshtim me detyrën që ka, për të bërë shërbime të caktuara. Nga ky definicion nënkuptojmë se korrupcioni është një lloj relacioni midis njerëzve të thjeshtë, masës së gjerë dhe njerëzve që janë në pushtet, e sidomos atyre që edhe pse noshta nuk janë pjesë e qeverisë në

---

\* Për rolin e FMN-së ndaj botës së tretë e sidomos ndaj botës islame shih librin e Mahatir Muhamedit, ish kryeministër i Malajzisë, *Një marrëveshje e re për Azinë*, bot. BFI-Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup, 2004.

<sup>3</sup> Ahmet Varol, “İslam Aleminde Geri Kalmışlık ve Açlık“ ([www.vahdet.com.tr](http://www.vahdet.com.tr)).

<sup>4</sup> *Sekreti i sundimit të botës (Procesverbalet e pleqësisë sioniste)*, Tiranë, 2002, f. 72.

pushtet ama bëjnë shërbime të caktuara publike, pra ajo që ne e quajmë administratë. Pra, për ta kryer një shërbim që personi në fjalë e ka detyrë pune, ai kërkon pagesë shtesë për këtë shërbim. E dini, kjo është gjë e shëmtuar dhe Pejgamberi a.s. e ka mallkuar atë që merr dhe atë që jep ryshfet. Në fakt, siç thamë më lart, kjo bëhet për ta shkelur ligjin e jo për ta zbatuar drejtë atë, për ç'arsye edhe shkakton anarki juridike e politike, po ashtu edhe ngecje të gjithmbarshme ekonomike. Duke qenë se në vendet e varfëra numri i të papunësuarve është tejet i madh, korrupcioni gjenë vend menjëherë te ata që kërkojnë vende pune, të cilët duke e luajtur ryshfetin e duke e shkelur ligjin dhe çdo normë tjetër njerëzore, ngjiten në piramidën e administrimit dhe të qeverisjes së shtetit, në të shumtën e rasteve duke e shkelur edhe rregullin sipas të cilit çdokush duhet të punësohet në vendin dhe pozitën për çka është i kualifikuar. Dobësia dhe paaftësia profesionale e këtyre njerëzve të ngjitur në qeverisje drejtpërdrejtë ndikon në të gjitha fushat e jetës, si në atë politike, juridike, gjyqësore, mbrojtëse, ekonomike etj. Këto punësime të këtilla me ryshfet zakonisht përdoren pastaj nga ndërmjetësit e këtij biznesi si një armë e fortë për t'i mbajtur të dëgjueshëm ata me anë të rrogës që ua japin atyre nëpunësve. Kjo është një traditë e kahmotshme e këtyre rasteve dhe shumë lehtë mundëson krijimin e bandave brenda strukturave shtetërore, me anë të të cilave pastaj do të tentohet rrënimi i gjithë atij sistemi në bazë të të cilit funksionon shteti.

- 2. Konfliktet** e brendshme, fqinjësore dhe ndërkombëtare që zhvillohen në një gjeografi të gjerë të botës islame. Kolonialistët evropianë pas tërheqjes së tyre nga kolonitë e tyre, pas vete lanë shumë probleme e varra që do të kullojnë vazhdimisht. Njëra prej këtyre problemeve është përçarja e përshkallëzuar e ummetit islam dhe si rrjedhojë e kësaj lëvizja ose mospërcaktimi i drejtë i kufinjve shtetërorë. Këto si dhe probleme të tjera, mbahen nën shënjestër të mprehtë të ish kolonozatorëve dhe sa herë që duhet të mbulohen dobësitë e tyre, ata e nxisin çështjen e kufinjve si dhe armiqësi të tjera të këtij lloji. E këtillë ka qenë në të kaluarën lufta Irak-Iran, Irak-Kuvajt, sot Etiopi-Eritre etj. Vetëm paramendoni sa i madh mund të jetë rreziku i mbajtjes gjallë i situatës kur mendon ose dikush të thotë se je i kërcënuar nga fqinji. Veprimi i parë që bëhet në këtë moment është armatosja. E pra, kjo e njëjta ndodh edhe në sistemin global me shtetet islame, ato fuqizohen, mobilizohen e armatosen me armët më të sofistikuara kundër njëra-tjetrës ose dhe kundër ndonjë shteti tjetër fqinj. Pra, ajo çka e mban gjallë dhe i jep jetë armatimit marramendës te këto vende të varfëra është vetëdija se je i kërcënuar. Kjo zaten mjafton që pastaj shumë shtete t'i lënë mënjane shumicën e angazhimeve të tyre në sferën ekonomike me çka e dëmton drejtpërdrejtë buxhetin e shtetit,



d.m.th. e nxit varfërinë edhe më tej. Këto ditë të kaluara kryeministri turk R.T. Erdogan i ka bërë një vizitë Pakistanit, pas tërmetit të fuqishëm që e goditi atë vend, dhe njëra prej fjalëve që e thotë përpara gazetarëve në Muzafferabad, pasi shpreh keqardhjen për këtë ndodhi, është edhe kjo: “Sikur të mendojmë pak se sa harxhime e investime bëjmë në armatim, atëherë këto katastrofa nuk duhet të na duken të patejkalueshme...”<sup>5</sup> Aq më tepër, nga krejt ky proces i armatimit, ata që më së tepërmi pëfitojnë me këtë rast janë prodhuesit e armëve, të cilët e kanë në duart fuqinë e tyre për të përcaktuar për çdo shtet veç e veç se sa armë dhe çfarë lloji armësh mund të prodhojë ai shtet...<sup>6</sup>

**3. Globalizmi.** Me këtë term nënkuptojmë një proces ose grup procesesh shumë të ndërlikuara ku kapitali, mallrat, shërbimet dhe pasuritë kulturore i tejkalojnë kufinj të mundësive të shkencës e teknologjisë. Ky proces ka dimensionin e tij ekonomik, politiko-juridik dhe kulturor.

Ata që globalizmin e vlerësojnë si një zhvillim pozitiv, parimet bazë të saj i përmbledhin në këta tituj: sekularizmi, demokracia liberale, ekonomia e tregut të lirë dhe shteti juridik kushtetutar.

Globalizimi i ekonomisë shpreh një proces që dita-ditës i sjell gjithnjë e më pranë prodhimet dhe tregjet e vendeve të ndryshme. Është një zhvillim që mbështetet në shtrirjen e tregtisë botërore edhe jashtë kufinjve të një vendi, duke e bartur kapitalin, shërbimet dhe teknologjinë në çdo vend të botës. Jeta ekonomike që i tejkalon kufinj të një vendi dhe që është mbinacionale, në çdo vend që mbërrin detyron ndryshimet në strukturën politike dhe juridike, me çja arrinë ta kaplojë gjithë jetën shoqërore të po atij vendi. Sipas aktorëve të këtij procesi ky është një zhvillim pozitiv për të mirën e mbarë njerëzimit dhe është një proces që nuk ka kthim mbrapa, i pashmangshëm mu si procesi i modernizmit.

Sot, me zhvillimin e procesit të globalizmit, nuk ka mundësi që lehtë-lehtë të mbulohen pamjaftueshmëritë ekonomike, qeverisjet e paafte antidemokratike si dhe rrugët e fitimit pa konkurrencë. Globalizmi ekonomik me vete sjell edhe një infrastrukturë të zhvilluar informimi dhe një teknologji të lartë. Udhëheqësit tanimë nuk mund ta pengojnë masën e gjerë të mos informohet lidhur me ngjarjet botërore. Jo vetëm jeta ekonomike, por edhe ajo politike detyrohet të jetë sa më konkurrense dhe sa më transparente.

---

<sup>5</sup> Gazeta ditore turke *Yeni Şafak*, 22 tetor 2005  
(<http://www.yenisafak.com.tr/arsiv/2005/ekim/22/p03.html>)

<sup>6</sup> Ahmet Varol, po aty.

Globalizmi, sipas këtyre, ndihmon futjen sa më të qetë në korrent edhe të procesit të sekularizmit. Sipas kësaj, ky është një proces që ec drejt krijimit të një shoqërie të hapur për bashkëjetesën e botëkuptimeve të ndryshme dhe që për pikësynim të tijin ka mënyrën e jetesës globale demokratike.

Natyrisht që kjo ishte njëra anë e medalionit. Ana tjetër është shumë e ndryshme. A thua globalizmi ekonomik është një proces që ec vetvetiu? Kush janë aktorët kryesorë të kësaj loje? Para së gjithash vërtet a ekziston një gjendje e globalizimit të kapitaleve, mallrave e shërbimeve? Procesi i globalizimit ekonomik sa vepron në pjesën e SHBA-ve, të BE-së e të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore e sa në pjesën tjetër të botës (globit)? Sa përqind e botës është brenda e sa jashtë këtij procesi? A thua për çka është më mirë të flitet: për globalizmin e vërtetë ekonomik apo për përqëndrimin gjithnjë e më të madh të forcave ekonomike vetëm në disa qarqe të caktuara?

Janë shkruar mjaft vepra akademike për secilën prej këtyre pyetjeve dhe për të gjitha mospërputhjet e tjera të këtij procesi. Marrë në përgjithësi, pretendimet kryesore të atyre që dalin kundër globalizmit ekonomik, mund t'i përmbledhim si më poshtë:

- a) Globalizmi po ec në vijën e një lloj diktature kapitali e patronësh, ku fitimi numërohet si vlera bazë, shpenzimi si një lloj ibadeti (adhurimi) dhe njerëzit si mushterinj të tyre. Ç'ë do që një periudhë të shkurtër kohore u kuptua se ky qëndrim nuk mbështetet në themele edhe aq racionale. Varfëria nuk u zvogëlua. Nuk u realizua një ndarje e drejtë e mirëqenies. Madje sipas disave ka ndodhur e kundërta e kësaj. Shumë shtete që mundoheshin “të fërgoheshin me vajin e vet”, si pasojë e këtij procesi, “mbetën edhe pa kokërr misri në shtëpi”.
- b) Globalizmi në shkallë të lartë e dobëson konceptin e shtetit të mirëqenies sociale, zhvillimi i të cilit kërkon një periudhë të gjatë kohore; e dëmton rëndë indin *komunitarian* dhe e dobëson ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore. Për ta parë këtë të vërtetë mjafton që t'u hidhet një shikim politikave monetare të Bankës Botërore (BB) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Këto institucione globale sa për së afërmi kujdesen për papunësinë, varfërinë, nivelin e të ardhurave të masave të gjera të popullit etj.?
- c) Aktorët e globalizmit ekonomik këtë lojë dëshirojnë ta luajnë aq gjerë e gjatë saqë nuk gjejnë dot kohë të mendojnë se çdo të bëjnë me masat e gjera njerëzore që i kanë futur në këtë lojë. Ndoshta formacioni i tyre – së paku i pjesës dërmuese të tyre – nuk është i pajisur me aftësitë për t'i kuptuar drejtë problemet e thella njerëzore. Dhe kjo shkakton paraqitjen

e dyshimeve serioze lidhur me gjendjen e dimensionit shpirtëror e moral të globalizmit.

- d) Lidhur me këtë pikë duhet theksuar edhe këtë: Pretendohet se globalizmi është një proces historik që s'i dilet dot përpara dhe që s'mund të pengohet. Nëse ky pretendim është i vërtetë, atëherë nuk na mbetet gjë tjetër pos "t'i përkulemi kaderit (fatit)". Një proces në të cilin njeriu nuk mund të ndikojë fare, sa mund të jetë ai proces njerëzor? Apo mos ndoshta me termin "i papengueshëm" nënkuptohet kjo: "mos ngreni zë se ju shkelim"? Sërish ata, së paku deri më sot, në veprimtaritë e tyre shumë rrallë kanë treguar interesim dhe ndieshmëri ndaj problemeve ekologjike, me çka gjatë gjithë kohës kanë shkaktuar revoltën dhe protestën e ekologjistëve ndaj këtij procesi.
- e) Sipas disa teologëve, ekonomia e globalizuar e ushqen një sekularizëm që i sjell dëm indit fetar e moral. Dinamikat shpirtërore nuk gjejnë mundësinë t'i japin ndonjë kahje këtij lloj globalizimi. Veprimtaritë ekonomike, ndoshta më shumë se çdo veprimtari tjetër njerëzore, qoftë në nivel global apo lokal, kanë nevojë për ndriçimin e rrugës nga ana e vlerave dhe parimeve shpirtërore-morale. Nuk duhet harruar se veprimtaritë globale mund të hapin varra të mëdha morale...<sup>7</sup>

### Ç) PËRMBYLLJE

Duke marrë parasysh se çfarë quajmë botë islame sot dhe cila është gjendja ekonomike e saj, konstatojmë se niveli mesatar i të gjitha këtyre vendeve është nën atë që quhet mirëqenie shoqërore, edhe pse një sërë prej këtyre vendeve kanë standard të lartë ekonomik, mirëpo shumica e vendeve të tjera zhyten në varfëri. Pastaj pamë se edhe pse disa vende islame kanë resurse të mjaftueshme natyrore për "t'u fërguar në vetvete", sërish të njëjtat i shohim të zhytura në borxhe të jashtme. Megjithatë, sot kemi mjaft vende islame që kanë treguar një rritje të konsiderueshme ekonomike dhe që njëkohësisht shërbejnë si model për zhvillimin dhe ngritjen e vendeve të tjera islame. Kështu është Malajzia, Turqia, Kuvajti etj.

Ndër shkaqet kryesore të kësaj gjendjeje mjerimi, pos atyre që vijnë nga natyra, respektivisht Zoti, veçuan: *përtacinë e muslimanëve, moskuptimin e drejtë të disa parimeve islame ose shtrembërimin e tyre gjatë historisë,*

---

<sup>7</sup> Prof. Dr. Mehmet S. Aydın, "Küreselleşmeye Genel Bir Bakış" në *Siyasi, Ekonomik ve Kültürel Boyutlarıyla Küreselleşme*, Ufuk Kitapları, Stamboll, 2002, f. 13-17.

*vjedhjen dhe plaçkitjen e pasurive natyrore të botës islame nga ana e kolonizatorëve dhe zbatimin e politikave të gabuara ekonomike dhe menaxhuese nga qeveritë vendore.*

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet sot bota islame dhe që kërkojnë zgjidhje urgjente janë: *korrupcioni, konfliktet e brendshme, fqinjësore dhe ndërkombëtare, globalizimi* etj. Natyrisht këtu mund të përfshihen edhe mjaft probleme e sfida të tjera relevante.